

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Lendita Pajaziti, në çështjen juridike të paditëses [REDACTED] Distrikti Ferizaj, të cilën e përfaqëson [REDACTED], me autorizim, kundër të paditurit I [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, për pagesën e borxhit, vlera e kontestit 5.228,46 €, pas seancës publike të mbajtur më 10.02.2016, në prezencën e përfaqësuesit të paditëses dhe në prezencën e të paditurit, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesë padia e paditëses [REDACTED] Distrikti Ferizaj, si e bazuar.

II. DETYROHET i padituri [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, që paditëses në emër të shpenzimit të energjisë elektrike pagesën e borxhit tia paguaj shumën prej 257.77 € (dyqind e pesëdhjetë e shtatë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent)

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditëses mbi lartësinë e shumës të aprovuara në pikën II të dispozitivit dhe atë 4.970.69€ (katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e nëntë cent)

IV. DETYROHET i padituri që paditëses të i paguaj shumën e cekura në pikën II, të dispozitivit, dhe atë shumën prej 257.77 € (dyqind e pesëdhjetë e shtatë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent), si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 75 €, të gjitha në afat prej 15 dite, pas marrjes së formës së prerë të aktgjyqimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësja, [REDACTED] Prishtinë në këtë Gjykatë me dt.17.07.2012 ka ushtruar propozim për përmbarim ndaj të paditurit si debitor për pagesën e borxhit në lartësi prej 5.316.11 € në bazë të dokumentit autentik faturës me shifër [REDACTED].

Kjo Gjykatë me aktvendim E.nr.1083/12, ka lejuar përmbartimin ndaj të paditurit si debitor, i padituri në aktvendim mbi lejimin e përmbartimit në afatin e paraparë ligjor me dt.21.08.2012 ka parashtruar kundërshtim me arsyetim se se borxhi në fjalë nuk e ka shpenzuar por i njëjti i është bartur nga njehsori tjetër, pronar i të cilit nuk ka qenë

Përfaqësuesi i paditëses në fjalën e tij ka deklaruar se mbetet në tërësi pran padisë dhe kërkesë padisë si dhe precizimit të saj duke shtuar se se objekt i kërkesë padisë është njehsori me shifër [REDACTED], n; t; cilin njehsor i padituri e ka shpenzuar energjin; elektrike andaj ka theksuar se nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetohet se i padituri ia ka borxh paditëses shumë e precizuar.

Ka kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesë padinë e paditëses ta aprovon si të bazuar, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I padituri në fjalën e tij ka deklaruar se mbesë pranë kundërshtimit, të paraqitur i cili tani konsiderohet përgjigje në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesë padinë e paditësit si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, për faktin se borxhi i cili mu është bartur nga shifra 11787 nga [REDACTED] në njehsorin tim me shifër [REDACTED] pa pëlqimin time, i njëjti borxh bëhet fjalë se i përket edhe periudhës para vitit 2008, e cila shihet edhe nga traksaksioni me shifër [REDACTED] ku konstatohet qart se si ka ardhur deri te kjo shumë që më është bartur, e cila është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për energjinë dhe rregulloren e miratuar nga ana e ZRRE-së, i njëjti borxh është përfshih edhe në ligjin mbi faljen, pamvarësisht se ky borxh mu është bartur në vitin më dt.26.11.2011, me të cilin veprim mu është mohuar një e drejtë që të jem edhe në listën mbi faljen e cila listë është përpiluar nga ana e paditëses.

Në njehsorin elektrik-traksaksionin me shifër [REDACTED] pronar i së cilës jam shihet se borxhi i tërësishëm është 5.228.46 euro, që përfshihë edhe borxhi i cili mu është bartur.

Ka kërkuar nga ana e gjykatës që shumë prej 5,002,90€ ta refuzon si të pa bazuar kurse shumë tjetër të borxhit prej 226€, ka theksuar se të njetin e ka shpenzuar dhe ka deklaruar se do t'ia përmbushi paditëses.

Gjykata në këtë çështje bëri administrimin e provave duke bërë shqimin dhe leximin e tyre: U lexua propozimi për ekzekutim që tani konsiderohet padi C.nr. 425/12 dt.17.07.2012, Kundërshtimi që konsiderohet përgjigje në padi e të paditurit dt.21.08.2012, Fatura me shifër 9018854 dt.20.05.2012, Urdhër lejimi i shifrës DFE 11878 në emër të [REDAKTUAR] e dt.26.01.2011 me përshkrimin PBSH i bartet pjesërisht borxhi nga shifra [REDAKTUAR] në shifrën [REDAKTUAR] sipas projektit të PBSH-së, Urdhër lejimi me shifër [REDAKTUAR] dt.26.01.2011 me përshkrimin PBSH i bartet pjesërisht borxhi nga shifra [REDAKTUAR] në shifrën [REDAKTUAR] sipas projektit të PBSH-së, transaksioni i konsumatorit-të paditurit me shifer DFE [REDAKTUAR] dt.09.12.2015, Autorizimi i paditëses dhënë përfaqësuesit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] prova e dorëzuar nga ana e përfaqësuesit të paditëses përmes emaili-t me personin zyrtar [REDAKTUAR] e dt.20.01.2016, fletëdorzimi i ankesës dt.12.03.2014 e paraqitur nga ana e të paditurit , pran ët paditëses me nor ref 938 për shifrën [REDAKTUAR] transaksioni i konsumatorit për të paditurin me shifër [REDAKTUAR] dt.19.01.2016.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Gjykata konsideron se mes palëve ekziston raporti juridiko-civile për shfrytëzimin e energjisë elektrike dhe kthimin e borxhit të krijuar sipas nenit 26 të LMD-së, dhe nga ky raport janë krijuar të drejta dhe detyrime në kuptim të nenit 148 të LMD-së, i cili fakt vërtetohet nga provat e administruara, faturat, traksaksioni i konsumatorit etj.

Meqë nga provat e administruara dhe atë konkretisht transaksioni me shifër [REDAKTUAR] shihet kuart se borxhi që është krijuar në këtë shifër me rastin e shpenzimit të energjisë elektrike nga viti 2002 deri me dt.26.01.2011, ku dhe iu është bartur në njehsorin elektrik me shifër [REDAKTUAR] shuma prej 5.002.90€. është borxh ku një pjesë e të cilës është krijuar para vitit 2008.

Gjykata pretendimin e të paditurit se një pjesë e borxhit është përfshihë në falje gjykata pas shqimit të transaksionit dhe provave të cila i ka sjell përfaqësuesi i paditëses respektivisht emailin e brendshëm të komunikimit është konstatuar se një pjesë e borxhit është përfshihë në falje, andaj dhe gjykata e ka marr parasysh pretendimin e të paditurit me rastin e vendosjes.

Se i padituri nuk gjendet në listën e faljes nga ana e paditëses nuk është faji i të paditurit pasi që paditësja me veprimet e brendshme administrative borxhi i cili është krijuar në shifrën [REDACTED] ia ka bartur të paditurit në njehsorin e tij elektrik me shifër [REDACTED] me dt.26.01.2011 se kinse ky borxh i përket periudhës pas vitit 2008 e cila nuk qëndron pasi që ky veprim është veprimi proceduralo-administrativ i paditëses kurse një pjesë e borxhit ashtu siq u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi i përket periudhës para vitit 2008

Andaj i padituri brenda afatit ligjor siq është përcaktuar edhe me ligjin mbi faljen duhet ta përmbush obligimin e tij ndaj paditëses për pjesën tjetër të borxhit cila i përket pas periudhës e cila është përfshij në ligjin mbi faljen dhe atë borxhin pas vitit 2009 ashtu siq parashihet me nenin 4 par.3 të Ligji Për Faljen e borxheve publike me Nr.05/L-043 i dt.02.07.2015, si ligj special.

Andaj në rastin konkretë një pjesë e borxhit i të paditurit ndaj paditëse sa përket pas vitit 2009 i cili sipas nenit të sipërcekur duhet të përmbushur sipas kushteve që përcaktohet me këtë ligj.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së andaj obligohet i padituri që të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për taksën gjyqësore për padi shumë prej 50€, si dhe për aktgjykim shumë prej 25€.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr. 425/12 më datë 10.02.2016**

**Gjyqtari,
Alban Beqiri**




KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
O DLUKA JE PRAVNOŠNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD,
FERIZAJ / UROSEVAC

4



11. 03 2016

Handwritten signature